



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 54 Prot.

Tiranë, më dt. 10 . 01 .2018

VENDIM

Nr.50, dt. 10.01.2018

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, dhe VKM nr.280, dt.01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar me VKM nr.756, dt.26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, në mbledhjen e datës 10.01.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin evazhdimit të procedurave të legalizimeve për objektin “Shtesë anësore dhe lartësi 1 kat në godinë me leje 2 kate” në lagjen 2, Rruga “Sedat Babani”, Korçë, me subjekt aplikues Z. Arjan Alfred Mema, në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike Korçë.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI KKR

Arta Dollani

KRYETAR
Mirela Kumbaro Furxhi

